

VENDIM
Nr. 99/2017

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR QEVERISJEN VENDORE”,
NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR
PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT[‡]**

(ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 54/2019, datë 8.5.2019)

Në mbështetje të nenit 78/1 të Kushtetutës dhe të neneve 55/1, 19/2 e 21/1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

1.	Bashkim Fino	Kryetar	(PS)
2.	Oerd Bylykbashi	Zëvendëskryetar	(PD)
3.	Edmond Leka	Anëtar	(PS)
4.	Saimir Tahiri	Anëtar	(PS)
5.	Klotilda Bushka	Anëtare	(PS)
6.	Nasip Naço	Anëtar	(LSI)
7.	Dhurata Çupi	Anëtare	(PD).

[‡] Me vendimin e Kuvendit nr. 54/2019, datë 8.5.2019 janë bërë këto ndryshime:¶

“1. Deputeti Korab Lita caktohet zëvendëskryetar.”¶

2. Deputeti Halil Jakimi caktohet anëtar.”¶

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.10.2017